

Kërkesë informacioni për vitin 2025 Bashkia Rrogozhine

Nr. I kerkeses	Data e kerkeses	Objekti I kerkeses	Data e Pergjigjes	Pergjigja	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1659	22.01.2025	Ju lutem, kërkojmë të na vini në dispozicion informacion në lidhje me këto pyetje: 1-Në bashkinë tuaj si menaxhohet trajtimi i mbetjeve urbane? Sa ton mbetje prodhohen në vit dhe a keni pasur mbështetje financiare nga “transferta e pakushtëzuar e qeverisë për njësitë vendore që parashikon mbështetje buxhetore për menaxhimin e mbetjeve urbane”? 2-Bashkia juaj e ka të përcaktuar se pas grumbullimit, transporti i mbetjeve do të kryhet drejt Landfillit të Sharrës në Tiranë, por kompania e cila trajton mbetjet urbane në Sharrë, prej disa muajsh ka ngritur shqetësimin për pamundësinë e trajtimit të mbetjeve për shkak të territorit të tejmbushur. A jeni vënë në dijeni për këtë problem? 3-A ka pasur raste kur Landfilli i Sharrës ka refuzuar trajtimin e mbetjeve nga bashkia juaj, për shkak të mospagesave të kostos së përpunimit apo pamundësisë për përpunim? Si keni vepruar me mbetjet? 4-Disa banorë ngrenë shqetësimin se mbetjet urbane në Bashkinë tuaj digjen. Për se ndodh ky fenomen për uljen e kostos së grumbullimit dhe transportit, apo Landfilli i Sharrës ka refuzuar përpunimin?		Nuk ka ende nje pergjigje (ne pritje)	Deleguar drejtorive perkatese	Nuk ka

--	--	--	--	--	--	--

1660	12.03.2025	1. A keni ofruar mbështetje financiare për organizatat jofitimprurëse (OJF) gjatë vitit 2024ë 2. Nëse keni ofruar mbështetje financiare, cila ka qenë forma e mbështetjes (grant, kontrata shërbimi, prokurim publik/tenderim, etj.)ë 3. Sa OJF kanë aplikuar për mbështetje financiare gjatë vitit 2024ë Ju lutem, specifikoni sipas formës së mbështetjes, nëse ka patur më shumë së një formë. 4. Sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetjeë Ju lutem, specifikoni sipas formës së mbështetjes nëse ka patur më shumë se një formë 5. Cila ka qenë buxheti i disbursuar për organizatë dhe në totalë Ju lutem, specifikoni sipas formës nëse ka patur më shumë se një formë 6. Keni ofruar mbështetje jofinanciare gjatë vitit 2024ë Cila është baza ligjore/ rregullatore që rregullon këtë formë mbështetjejeë 7. Nëse keni ofruar mbështetje financiare, sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetjeë Cili ka qenë lloji i mbështetjes jofinanciare të ofruar (mjedise, trajnime, ndarje eksperiencash, etj)ë 8. Sa është numri i konsultimeve publike të realizuara nga institucioni juaj gjatë vitit 2024ë 9. A ka institucioni juaj koordinator për njoftimin dhe konsultimin publikë Nëse PO, ju lutem citoni kontaktin. 10. A ka institucioni juaj koordinator për shoqërinë civileë Nëse PO, ju lutem citoni kontaktin. 11. Sa OJF kanë marrë pjesë në konsultime publike të organizuara nga Institucioni juajë 12. Sa përqind (%) e projektligjeve / akteve nënligjore të hartuara nga institucioni juaj janë si rezultat i konsultimeve me OJF-tëë 13. Ajanë të përfshirë përfaqësues të OJF-ve në organe këshillimore të institucionit tuajë Nëse PO, cilat janë këto organe këshillimore dhe sa OJF janë të përfshirë në toë 14. Ajanë përfshirë OJF në grupet e punës së ngritura të institucionit tuajë Nëse PO, cilat janë këto grupe pune dhe sa OJF janë të përfshirë në to?		Nuk ka ende nje pergjigje (ne pritje).	Deleguar ne drejtorine perkatese.	Nuk Ka
------	------------	---	--	--	-----------------------------------	--------

1661	19.03.2025	1. A ka pasur bashkia juaj buxhet vjetor te planifikuar per rinine (grup moshen 15-29 vjec) per perjudhen janar - dhjetor 2024ë Nese po, sa perqind te shumes totale te buxhetit zene keto zeraë Nese jo, ju lutem a mund te na tregoni disa nga arsyet perse nuk ka nje planifikim te tilleë 2. Sa eshte numri total i punonjesve ne Bashkine tuaj (2024)ë Sa prej tyre jane femra dhe sa jane meshkujë Sa prej tyre i perkasin personave me aftesi te kufizuara, dhe sipasa gjiniseë 3. Sa eshte numri i te rinjve (18-29) punonjes te bashkise tuaj ne vitin 2024ë Sa prej tyre jane femra dhe sa jane meshkujë Sa prej tyre i perkasin personave me aftesi te kufizuara, dhe sipas gjiniseë 4. Sa eshte numri i te rinjve (18-29) te punesuar ne bashkine tuaj, te cilet mbajne pozicione drejtuese dhe vendimmarreseë (zv.kryetar, drejtor, etj). Sa prej tyre jan femra dhe sa meshkujë Sa prej tyre i perkasin personave me aftesi te kufizuara, dhe sipas gjiniseë 5.A ka Bashkia juaj politika rinore te zhvilluara specifikaisht per grup moshen 15-29 vjecë Nese jo, ju lutem a mund te na tregoni disa nga arsyet perse nuk ka te zhvilluar nje politike te tilleë 6. Akeni ne institucionin tuaj, drejtori, sektore, staf te dedikuar per rinineë Prej sa kohesh jane funksionaleë 7. A ka struktura rinore te ngritura ne Bashkine tuaj dedikuar grupmoshes se te rinjve 15-29 vjec (qendra/zyra rinore, keshilla rinore,parlament rinor,struktura konsulative rinore, etj.) per perjudhen jana-dhjetor 2024. Nese po, cilat jane atoë 8.Me ke keni bashkepunuar per ngritjen e strukturave te tilla (organizata rinore, grupe te rinjsh, individe, etj.) 9.A keni nje plan veprimi per Keshillin Rinor Vendor (KVR) ë Sa aktivitete jane organizuar nga KVRpergjate 2024ë 10.Per cfare lloj mbeshtetje/iniciativa/bashkepunime keni nevojë per te permiresuar funksionet e KVR ne qytetin tuajë 11.Sa te rinj jane te perfshire ne KVR ë Sa prej tyre jan femra dhe sa jane meshkujë Sa prej tyre i perkasin personave me aftesi te kufizuara, dhe sipas gjiniseë 12.A keni pasur ju forma te tjera bashkepunimit (me grupe te rinjsh, organizata rinore, etj.) per zhvillimin e aktiviteteve me fokus rinineë Nese po ku kane konsistuar atoë 13. Sa eshte me perafersi pjesemarrja e te rinjve ne konsultimet publike te zhvilluara nga bashkiaë Cilat jane disa nga mjetet apo mekanizmat qe perdor bashkia ne perfshirjen e te rinjve ne te tilla proceseë 14.Lutemi listoni mjetet e komunikimit qe perdor bashkia juaj dhe link perkatese te faqes se webit te bashkise (website) dhe rrjetet sociale si Facebook dhe Instagram. 15.Sa eshte numri total iperfitueseve nga Skema e Ndiemes Ekonomike per vitin 2024ë Sa prej tyre jan femra dhe sa meshkujë 16.Sa eshte numri i te rinjve (15-29 vjec) perfitues nga Skema e Ndimes Ekonomike per vitin 2024ë Sa prej tyre jn meshkuj dhe sa femraë 17.Sa eshte numri total i Perfitueseve te pageses se Aftesise se Kufizuar per vitin 2024ë Sa prej tyre jan femra dhe sa meshkujë 18.Sa eshte numri i te rinjve (15-29 vjec) perfitues te pageses se Aftesise se Kufizuar per vitin 2024ë Sa prej tyre jan femra dhe sa meshkujë 19.Sa eshte numri total i l personave te cilet jane pjese e Sherbimeve te Kujdesit Shoqeror per vitin 2024ë Sa prej tyre jan femra dhe sa meshkujë 20. Sa eshte numri i te rinjve (15-29 vjec) te cilat jane pjese e Sherbimeve te Kujdesit Shoqeror per vitin 2024? Sa prej tyre jan femra dhe sa meshkuj?	29.10.2025	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social Ka kthyer pergjigje si me poshte : • Pyetja 15 e kërkesës suaj për informacion. ➤ Sa është numri total I përfituesve nga skema e Ndihmës Ekonomike për vitin 2024? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? ✓ Numri total I përfituesve është 159 ku 17 janë femra dhe 142 meshkuj. • Pyetja 16 e kërkesës suaj për informacion. ➤ Sa është numri I të rinjve (15-29 vjec) përfitues nga Skema e Ndihmës Ekonomike për vitin 2024?Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj ? ✓ Numri total I të rinjve është 16 përfitues ku 9 janë meshkuj dhe 7 femra. • Pyetja 17 e kërkesës suaj për informacion. ➤ Sa është numri total I përfituesve të Pagesës së aftësisë së Kufizuar për vitin 2024? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? ✓ Numri total përfituesve të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar për vitin 2024 është 324 ku 144 janë femra dhe 180 meshkuj. • Pyetja 18 e kërkesës suaj për informacion. ➤ Sa është numri I të rinjve (15-29 vjec) përfitues të Pagesës së aftësisë së Kufizuar për vitin 2024. Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? ✓ Numri I të rinjve përfitues është 90 ku 46 janë femra dhe 44 meshkuj • Pyetja 19 e kërkesës suaj për informacion. ➤ Sa është numri total I personave të cilët janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2024? ✓ Numri total përfituesve te cilët janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2024 eshte 109 persona. ✓ Pyetja 20 e kërkesës suaj për informacion. ➤ Sa është numri I të rinjve (15-29 vjec) të cilët janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2024? Numri total I të rinjve përfitues të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror është 21 ku 12 janë femra dhe 9 meshkuj.	Kerkese e dorezuar.	Nuk Ka
------	------------	--	------------	--	---------------------	--------

1763	30.06.2025	Sa është numri i tenderave të realizuara për periudhën Janar 2024-Qershor 2025? Kopje të listës së kontratave të lidhura për periudhën Janar 2024-Qershor 2025 ku të përfshihen të dhëna mbi operatorin ekonomik të kontraktuar, vlerën e kontratës, datën e lidhjes së kontratës, objektin etj; Kopje të dokumentacionit në lidhje me realizimin e kontratave të mësipërme.		Nuk ka ende nje pergjigje (ne pritje)	<i>Ne proces shqyrtimi.</i>	Nuk Ka
1764	16.01.2025	1. Sa eshte sasia e mbetjeve te gjeneruara nga Bashkia Rrogozhine sipasviteve ne tone per vitet 2015 – 2024? 2.Ku jane depozituar mbetjet e gjeneruara nga Bashkia Rrogozhine per vitet 2015 -2024ë Per secilin vit percaktoni sasinë ne tone dhe vendin e depozitimit? 3. A ka firmosuar Bashkia Rrogozhine Aneksin Forma e Angazhimit me Integrated Energy BV SPV(Landfilli i Tiranes)ë A ka depozituar Bashkia Rrogozhine mbetje ne kete landfill nga viti 2017ë Nese po jepni sasite sipas viteve qe keni depozituar prane ketij subjekti, tarifen per ton te aplikuar, Vlerën totale te pagesave te kryera per depozitimin sipas viteve. Me çfare tarife kenidepozituar ne kete landfill? 4.A ka firmosur Bashkia Rrogozhine ndonje marreveshje meLandfillin/Inceneratorin e Elbasanit per depozitimin e mbetjeveë Nese po njekopje te saj. A ka depozituar Bashkia Rrogozhine mbetje ne kete landfill nga viti 2017ë Nese po jepni sasite sipas viteve qe keni depozituar prane ketij landfilli, tarifen per ton te aplikuar, vleren totale te pagesave te kryera per depozitimin sipas viteve. Me çfare tarife keni depozituar ne kete landfill? 5. Nese keni shkuar per depozitim tek Landfilli Elbasanit dhe jo i Tiranes, kure keni marre kete vendim dhe cila eshte arsyeja e ketij vendimië Cfare analizekeni kryer? 6. Per kontratën e "Sherbimi, Pastrimit, Gjelberimit, Varreza, Dekorit, ne territorin e Bashkise Rrogozhine per vitet 2018-2022 (per 4 vite)" me vlere 179 540 000 leke pa TVSH, lutem kopje te kontrates, dst, dhe konfirmoni nese brenda kesaj pagese perfshihej dhe transportimi i mbetjeve ne landfill dhe tarifa e depozitimit te tyre ne landfille te autorizuara. Nese perfshihet ku i ka derdhur mbetjet kontraktori keto vite dhe dokumentat vertetues qe ka depozituar tek ju si Organi pergjegjes per administrimin e mbetjeve. Keto dokukenta vertetues jane kusht per provimin e kryerjes se sherbimit sipas kontrates nga kontraktuesi duke konfirmuar depozitimin ne landfille te autorizuara dhe vetëm me pas mund te kryet pagesa per sherbimin e marre. 7. Per kontratën e "Sherbimi i Pastrimit, Gjelberimit, Mirembajtje Varreza, Dekorit, ne territorin e Bashkise Rrogozhine (per 5 Vite)" me vlere 304 164 000 leke pa TVSH, lutem kopje te kontratës, dst, dhe konfirmoni nëse Brenda kesaj pagese perfshihej dhe transportimi i mbetjeve ne landfill dhe tarifa e depozitimit te tyre ne landfille te autorizuara. Nese perfshihet ku i ka derdhur mbetjet kontraktori keto vite dhe dokumentat vërtetues qe ka depozituar tek ju si Organi pergjegjes per administrimin e mbetjeve. Keto dokukenta vertetues jane kusht per provimin e kryerjes se sherbimit sipas kontratës nga kontraktuesi duke konfirmuar depozitimin ne landfille te autorizuara. 8. Pse per te njejtin sherbim te ofruar nga i njejti subjekt, vlere vetore pa TVSH ne vitet 2018-2022 ka qene 44 885 000 leke pa TVSH dhe ne vitet 2022-2027 ajo rezulton ne 60 832 800 leke pa TVSH, nje rritje prej 35%ë Si keni dale ne kete fond limit per te dyja vitet kur e keni logaritur ate Cfare ka ndryshuar? 9.Lutem na vendosni ne dispozicion nje kopje te "Planit Vendor te Menaxhimit te Integruar te Mbetjeve" qe keni miratuar apo qe eshte ne format draft.		Nuk ka ende nje pergjigje (ne prritje)	<i>Deleguar drejtorive perkatese</i>	Nuk ka

1766	11.09.2025	1. Sa hidrocentrale (HEC-e) janë ndërtuar në bashkinë tuaj në 15 vitet e fundit, prej janarit 2010 deri në gusht 2025? Ju lutem specifikoni: numrin e HEC-eve dhe vitin kur është ndërtuar, emërtimin e HEC-eve dhe kompaninë ndërtuese, madhësinë e tyre dhe sasinë e energjisë që prodhojnë për secilin vit. 2. Sa prej këtyre hidrocentraleve janë ende në funksion? 3. Sa prej këtyre hidrocentraleve nuk janë në funksion? Specifikoni me emër dhe vendndodhje secilin HEC që nuk është në funksion. 4. A ka projekte të reja për ndërtimin e hidrocentraleve në territorin e bashkisë suaj aktualisht? Nëse po, rendisni numrin e HEC-eve që kanë marrë leje, por janë në proces ndërtimi apo ende nuk ka nisur puna për ndërtimin e tyre? Specifikoni emrat e tyre, kompanitë ndërtuese, afatin e përfundimit të punimeve, kapacitetin e tyre dhe se sa energji pritët të prodhojnë pasi të vihen në punë. 5. Cilët janë lumenjtë apo degët e lumenjve, ku janë ndërtuar këto HEC-e ose planifikohet ndërtimi i tyre (nëse ende nuk kanë nisur)? Specifikoni emrat e HEC-eve dhe lumin apo degët e lumenjve ku janë ndërtuar apo pritët të ndërtohet. 6. Cilat janë përfitimet ekonomike për bashkinë tuaj nga këto hidrocentrale që janë ndërtuar apo që janë në fazë ndërtimi? Kini parasysh këtu të ardhurat nga HEC-et, sa të punësuar janë në këto HEC-e nga bashkia juaj, taksat dhe shërbimet. Ju lutem, specifikoni të dhënat për secilin HEC.	01.10.2025	NE BASHKINE RROGOZHINE NUK REZULTON TE KETE HEC-e.	<i>Kerkese e dorezuar.</i>	<i>Nuk ka</i>
------	------------	---	------------	--	----------------------------	---------------

